89	21.05.2021	10.06.2021	Informacion ne lidhje me kostot/doze vaksine specifike	Pergjigje/Informacion per miratimin e akteve ligjore si : Ligji Nr.58, datë 07.05.2021 është miratuar akti normativ, me fuqinë e Ligjit Nr. 15, datë 7.4.2021 “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, “Për miratimin e tekstit te marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V., dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-covid-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë”, miratuar me ligjin nr. 2/2021, të ndryshuar” (https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/53598); Akti normativ nr. 22, datë 21.05.2021 është miratuar marrëveshja e nënshkruar e Furnizimit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret” a.s.” , i cili po ndjek procedurat e miratimit parlamentar. (https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54614); Ligji Nr. 40, datë 23.03.2021 është ratifikuar marrëveshja ndryshuese me shkëmbim letrash e Marrëveshjes së Angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës Gavi për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat covid-19 (covax facility), miratuar me Ligjin nr. 134/2020”, mekanizwm nga i cili kanë ardhur vaksinat asstrazeneca. (https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/53584); Ligji Nr. 62, datë 07.05.2021 është miratuar akti normativ me fuqinë e Ligjit Nr. 19, datë 16.04.2021, “Për Miratimin e Marrëveshjes së Nënshkruar, ndërmjet “Human Vaccine” llc dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën kundër covid-19 “Sputnik v”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit Gamaleya për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi” (http://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/53602)	E plotë

90	24.05.2021	03.06.2021	Informacion mbi numrin e qendrave te reja komunitare per shendetin mendor dhe qendrave rezidenciale te ngritura 2014-2020 ne RSH	Pergjigje/Informacion: Ekzitojnë 10 (dhjetë) Qendra Komunitare të Shëndetit Mendor/QKSHM, të cilat janë shërbime ambulatorore të specializuara të shëndetit mendor, që ofrojnë shërbime multidisiplinare (ekip multidisiplinar: psikiatër, infermier, psikolog, punonjës social, terapist okupacional, etj.) dhe multidimensionale në nivel komunitar. Këto qendra janë shpërndarë me vendodhjet si :- Tiranë 3 (tre) QKSHM; - Berat 1 (një) QKSHM; - Gramsh 1 (një) QKSHM; - Elbasan 1 (një) QKSHM ; - Korçë 1 (një) QKSHM; - Shkodër 1 (një) QKSHM; - Vlorë 1 (një) QKSHM; - Kavajë 1 (një) QKSHM. Në zonat ku nuk janë ngritur ende QKSHM-të, shërbimi i specializuar mbulohet nga kabinetet neuro-psikiatrike pranë shërbimeve spitalore, të cilat ofrojnë shërbim ambulator/konsulta. Aktualisht në nivel kombëtar janë ngritur dhe funksionojnë 14 (katërmëdhjetë) Shtëpi të mbështetura, të cilat janë njësi funksionale të shërbimeve të shëndetit mendor, të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve rezidenciale për individët në një ambient sa më të ngjashëm me atë familjar, ku qëllimi kryesor është përkujdesja dhe rehabilitimi i individëve me një çrregullime kronike të shëndetit mendor. Vendodhjet e tyre janë: 2 (dy) në Tiranë, 3 (tre) në Vlorë, 4 (katër) në Shkodër, 2 (dy) në Elbasan, 2 (dy) në Korçë dhe 1 (një) në Kavajë, duke akomoduar rreth 150 persona me çrregullime kronike të shëndetit mendor, ish-rezidentë kronikë të spitaleve psikiatrike.	E plotë
91	24.05.2021	02.06.2021	Informacion per momentin e hapjes se QSH verore	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH	E deleguar
92	25.05.2021	15.06.2021	Informacion per masa lehtesuese per periudhe referente, grumbullimet, akomodimet e tyre, mbledhjet ne mjedise te mbyllura, levizjet ne grupe, etj	Pergjigje/Informacion per lejimin e grumbullimeve deri 50 veta ne ambiente te jashtme/te hapura; lehtesimi i masave diktohet ne varesi te studimit te dinamikes se situates epidemiologjike ne vend dhe perhapjes se infeksionit covid19. Azhormimi i masave anticovid ne: https://shendetesia.gov.al/category/lajme	E plotë
93	25.05.2021	09.06.2021	Informacion ne lidhje me vaksinime te kryera ne mbeshtetje te turizmit ne periudhe refernete, kriteret e perzgjedhjes; protokolli per mbrojtjen nga covid19	Pergjigje/Informacion ne lidhje me percjelljen e disa pikave ne OSHKSH si dhe miratimi i Urdhrit Nr. 353, date 29.05.2020, publikuar FZ. Nr. 107, date 08.06.2020	E plotë
94	27.05.2021	01.06.2021	Informacion ne lidhje me nr total vaksinash te mberritura ne periudhe referente; kategorite e vaksinuara; nr personash te vaksinuar; ku jane duke u aplikuar dozat e vaksinave specifike	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH; ISHP	E deleguar
95	28.05.2021	02.06.2021	Informacion ne lidhje me rinovim libeze shendeti per QSH	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH	E deleguar

96	30.05.2021	08.06.2021	<p>Informacion ne lidhje me : arsye pse nuk ka cdo bashki e vendit qendra per rehabilitimin e femijeve te dhunuar apo abuzuar; sa qendra për rehabilitimin e fëmijë të dhunuar apo abuzuar, ka në të gjithë vendin, dhe ku janë të shpërdarë këto, si dhe a ka nevojë për shtimin e tyre duke patur parasysh që rastet e denoncuar po rriten; si fëmijë aktualisht janë duke u rehabilituar në këto qendra; si funksionon puna në qendrat e reabilitimit dhe sa zgjat procesi i reabilitimit të një fëmijë të abuzuar seksualisht;-Info nese MSHMS ka dijeni të nje sere problemeve që kanë Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve nëpër bashki si dhe cfarë masash do marrë MSHMS për të përmirësuar kushtet në lidhje me këto struktura</p>	<p>Pergjigje/Informacion:MSHMS disbursoi gjatë muajit prill 2020, fonde për 14 Bashki në masën 61 milion lekë, për ngritjen apo zgjerimin e shërbimeve komunitare për kategori të ndryshme përfituesish, kryesisht për fëmijët, gratë viktime të dhunës në familje, të moshuarit, si dhe ofrimin e shërbimit në familje për individët/familjet përfituese, duke pasur parasysh respektimin e protokolleve të rrepta për mbrojtjen nga infektimi me Covid-19. Gjatë vitit 2020 janë mbështetur nga MSHMS zbatimi i projekteve të ofrimit të shërbimeve të përkudetit social, ku përfitues të drejtpërdrejtë janë fëmijët, në bashkitë Gjirokastrë, Elbasan, Lushnje, Lezhë dhe Librazhd. Nga raportimi dhe inspektimi rezulton se gjatë zbatimit të këtyre projekteve për vitin 2020 kanë përfituar përkujdesje me shumë se 353 fëmijë në nevojë. Edhe gjatë vitit 2021 përmes Fondit Social , MSHMS ka vijuar mbështetjen për financimin në vitin e dytë për zbatimin e këtyre projekteve, në këto 5 bashki. Gjatë viti 2021, në kuadër të Fondit Social gjithmonë me fokus fëmijët, janë financuar zbatimi i projekteve për ngritjen e shërbimeve të reja për fëmijët më aftësi të kufizuar apo në situatë risku, në bashkitë Kavajë, Rrogozhinë, Maliq. Në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit gjatë viti 2021 do të pilotohen 2 shërbime parandaluese të institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkudetit shoqëror, në bashkinë Vlorë dhe Korçë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka në varësi të saj dy qendrat kombëtare: a. Në Qendrën Kombëtare të viktimave të Dhunës në Familje--Gjatë vitit 2020 janë trajtuar gjithsej 60 përfitues nga të cilat 23 gra dhe 37 fëmijë. Aktualisht në qendër janë 19 përfituese, 7 gra dhe 12 fëmijë. b. Në Qendrën Kombëtare pritëse të viktimave të trafikimit- janë trajtuar gjithashtu edhe fëmijë nën moshën 18 vjeç nga të cilat: Aktualisht për periudhën janar- maj 2021 po trajtohen 3 fëmijë Ka 2 Qendra Kombëtare Emergjence që ofrojnë shërbim emergjent për rastet e fëmijëve viktime të dhunës, abuzimit, neglizhimit si dhe punojnë për fuqizimin e shërbimeve mbrojtëse për fëmijët viktime të trafikimit dhe fëmijët viktime të abuzimit seksual. Qendrat bashkëpunojnë me të gjitha njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në vend në mënyrë që të sigurojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për fëmijët. Qendrat e emergjencës, nëpërmjet stafeve të specializuara ofrojnë shërbime mbështetëse direkte për familjet që synojnë fuqizimin e tyre si dhe aftësimin prindëror. Qendra "LILIUM", e ngritur me Urdhër të Ministrit Nr.817, datë 27.11.2018, përbën një angazhim të përbushur të qeverisë në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga GREVIO, në kuadër të raportimit për zbatimin e Konventës së Stambollit si dhe një detyrim ligjor në zbatim të Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar. Kjo qendër është e para në Shqipëri, që ofron modelin socio-shëndetësor, me një ekip multidisiplinar me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë, jep shërbim të specializuar sipas standarteve 24 orë çdo ditë të javës. Qendra ofron një shërbim afatshkurtër 24 – 72 orë, të integruar për të gjithë pavarësisht moshës, gjinisë, etnisë, racës, orientimit seksual apo aftësisë së kufizuar. Shërbimi në këtë qendër koordinohet edhe me shërbime</p>	E plotë
----	------------	------------	--	--	---------

				<p>të tjera për trajtimin afatgjatë të tyre, ku një rol të veçantë do të luajë bashkëpunimi me Mekanizmat e Referimit kundër dhunës në familje dhe Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve.</p> <p>Qendra “Lilium” ka trajtuar në total, që nga dhjetori i vitit 2018 (muaji kur daton inagurimi) e deri më sot, 77 viktime të dhunës seksuale, nga të cilët 63 raste janë të fëmijë.</p> <p>Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është institucioni i cili monitoron punën e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës. Në bazë të nenit 49, pika 3, gërma ç) të Ligjit Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet t’i raportojnë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse;</p> <p>Vazhdon përmirësimi i performancës së sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të mbrojtjes së fëmijës nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, Në nivel vendor janë ngritur dhe funksionojnë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) të cilët kanë përgjegjësi identifikimin, vlerësimin, marrjen në mbrojtje dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në rrezik dhunë, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi. Në të gjithë vendin kemi një rritje të këtij numri në 241 punonjës për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë vendosur si njësi për mbrojtjen e fëmijëve në 61 bashki dhe punonjës të mbrojtjes së fëmijëve në njësitë administrative. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë vendin, janë struktura të ngritura në drejtorinë e shërbimeve sociale në bashki, pra janë nënpunës civile të administratës vendore, bashkisë. Në referencë të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, bashkia ka rolin dhe përgjegjësinë kryesore në parashikimin e buxheteve për realizimin e punës së NJMF si dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve në territorin e tyre.</p> <p>Nga të dhënat e Njësive të Mbrojtjes të Fëmijëve rezultojnë se gjatë viti 2020 janë menaxhuar 2,193 raste në total të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe nga këto raste të reja janë 1020.</p> <p>Nga të dhënat për vitin 2020, rezultojnë se 166 raste janë marrë në mbrojtje për shkak të dhunës psikologjike dhe 69 raste të fëmijëve të abuzuar fizikisht. Ndërkohë për arsye të dhunës seksuale janë marrë në mbrojtje 65 raste për vitin 2020. Për periudhën janar - mars 2021 Njësitë e Mbrojtjes të Fëmijëve kanë menaxhuar 1,417 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</p> <p>Nga të dhënat rezultojnë se 187 raste janë marrë në mbrojtje për shkak të dhunës psikologjike dhe 69 raste të fëmijëve të abuzuar fizikisht.</p> <p>Ndërkohë për arsye të dhunës seksuale janë marrë në mbrojtje 32 raste për këtë periudhë kohore.</p>	
97	02.06.2021	09.06.2021	Informacion protokollin anticovid per sezonin turistik	Pergjigje per miratimin e Urdhrit Nr. 353, date 29.05.2020, publikuar ne FZ Nr. 107, date 08.06.2020	E plotë
98	02.06.2021	15.06.2021	Informacion ne lidhje me nr staf mjekesor qe punon ne SMFR; specialitetet qe jane ne SMFR; nr. Bluzave te bardha qe punojne ne SMFR qe vijne nga jashte per te sherbyer	Pergjigje per nr stafi: 127 mjekte, infermiere, teknike imazherie; nr.specialitetet 198; specialitetet ne fushen e urgjences mjekesore, mjekesise iterne, neurologjise, kardiologjise, kirurgjise se pergjithshme, anestezi reanimacioni, imazheri, farmaci, laboratorike, kirurgji orologjike, urgjenca kirurgjikale, semundje infektive,okulistike, ORL, neurokirurgji,kirurgji torakale, kirurgji vaskulare, ortopedi dhe traumatologji dhe transfuziologji; nr.personel	E plotë

				mjekesore qe vjen nga jashte per te sherbyer ne SMFR 56 total nga te cilet 18 personel mjekesor	
99	03.06.2021	10.06.2021	Informacion nese ministri ka marre leje vjetoreper priudhe refernete; urdher sherbimi per levizje ne qytete te ndryshme per periudhe referente	Pergjigje nuk ka pasur leje vjetore dhe urdher sherbimi per periudhen referente	E plotë
100	03.06.2021	09.06.2021	Informacion ne lidhje me listen e produkteve biocide qe perdoren per deiznfektim	Pergjigje referuar shtojces V te VKM nr. 933, date 25.11.2020 "Per percaktimin e rregullave per kriteret e vleresimit te produkteve biocide dhe te procedures se dhenies se autorizimit te vendosjes se tyre ne treg" (botuar ne FZ Nr. 210, date 02.12.2020 dhe ne https://shendetesia.gov.al/shendeti-publik-2/) percaktohet lista e lendeve vepruese te miratuara	E plotë
101	05.06.2021	10.06.2021	Informacion ne lidhje me shtrim ne spital psikiatrik	Pergjigje per plotesimin e kerkeses me informacion shtese ne menyre qe te vendoset kontakt me mjekun e familjes si dhe te iniciohet nje vleresim i plote prane Qendres Komunitare te Shendetit Mendor si gjeneralitete te rastit te referuar; vendbanimi i sakte; QSH ku eshte i regjistruar personi; nr kontakti.	E plotë
102	07.06.2021	30.06.2021	Informacion ne lidhje me vlefshmerine e pasaportes se vaksinimit per udhetime jashte RSH	Informacion qe pasaporta e vaksinimit apo certifikata e vaksinimit mund te merret nga portali e-albania dhe te gjithë shtetasit e huaj qe e kane kryer vaksinën ne strukturat shendetesore shqiptare apo pikat e vaksinimit mund te printojne nga ky portal kete dokument	E plotë
103	08.06.2021	14.06.2021	Informacion per vaksinim	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH	E deleguar
104	09.06.2021	30.06.2021	Informacion per vendosje dispozicion Urdher Nr. 738, date 22.10.2018	Pergjigje vendosje ne dispozicion Urdhri	E plotë
105	09.06.2021	14.06.2021; 14.07.2021	Informacion ne lidhje me mundesine per kontaktimin me autoritet shedetesor rajonal per zhurmat e shkaktuara nga fasoneri	Percjellje per kompetence dhe trajtim ISHP; Kthim Pergjigje te ISHP	E deleguar/ E plotë
106	09.06.2021	14.06.2021	Informacion per bonus bebe	Percjellje per kompetence dhe trajtim SHSSH	E deleguar
107	10.06.2021	18.06.2021	Informacion në kuadër të hartimit të ri të Planit Kombëtar të Veprimit për Romët për vitin 2021-2025, si: masat e reja/risi qe do të përmbajë plani i veprimit për këto dy minoritete ndryshe nga plani i mëparshëm; informacioni nese janë përshtatur aktivitetet e parashikuara me rimëkëmbjen ekonomike të familjeve të varfëra në post pandemi; informacion se kur pritet te miratohet dhe publikohet ne FZ ky plan.	Pergjigje per: Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve është një angazhim i ri i Qeverisë Shqiptare me kohështrirje 2021-2025, i cili targeton Minoritetin Romë dhe Egjiptianë. Plani i ri i veprimit është hartuar në vijim të deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi integrimin e Romëve në procesin e zgjerimit të Bashkimit European të mbajtur në Poznan dhe bazohen në rekomandimet e Seminarit të katërt të dialogut mbi politikat për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve; si dhe Strategjinë e re të BE për romët. Gjithashtu është bazuar në nevojat/problematicat që përballen aktualisht anëtarë të të dy minoriteteve si dhe janë parashikuar masa në përputhje me nevojat urgjente të krijuar nga Pandemia- COVID 19. Një fushë e re në këtë plan është Antigipsizmi i cili ka për qëllim njihjen dhe adresimin e tij në politikave publike si dhe përmes ndryshimeve sistemike dhe strukturore do të garantohet një shoqëri e çliruar nga diskriminimi ndaj Romëve dhe Egjiptianëve. Informacioni perpublikimin dhe miratimin e planit brenda vitit.	E plotë
108	11.06.2021	15.06.2021; 14.07.2021	Informacion/kerkese per disponim karte te SUOGJ "Mbretresha Geraldine"	Percjellje per kompetence dhe trajtim SUOGJ "Mbretresha Gerladine"; Kthim Pergjigje te SUOGJ-se	E deleguar/ E plotë

109	12.06.2021	15.06.2021	Informacion ne lidhje me publikimin e te dhenave per numer te infektuarish, nr te vdekjeve, nr te sherimeve	Pergjigje ne lidhje me gjenerimin e informacionit ne https://shendetesia.gov.al/category/lajme ku publikohen te dhenat ne terma ditore per te gjitha aktivitetet perfs hire dhe situaten lidhur me covid 19	E plotë
110	14.06.2021	23.06.2021	Informacion per licencim psikologe dhe punonjes sociale te personave te cilet kane mbaruar bachelor, pune sociale, master psikologji	Pergjigje në bazë të Ligjit Nr. 164/2014, i ndryshuar, për të qenë anëtar i Urdhërit të Punonjësit Social të Republikës së Shqipërisë dhe për t'u licensuar për ushtrimin e profesionit të Punonjësit Social, duhet që të dyja diplomat të jenë në fushën e punës sociale. Ndërkohë, për ata persona të cilët kanë përfunduar studimet bachelor në punë sociale, dhe master në një fushë tjetër, në momentin e ngritjes së Urdhërit të Punonjësit Social, do të regjistrohen përkohësisht në një regjistër të posaçëm të Urdhrit deri në përmbyshjen e kriterëve të nevojshme të anëtarësimit, sipas nenit 19, “Dispozitat Kalimtare” të Ligjit Nr. 164/2014, të ndryshuar.	E plotë
111	15.06.2021	17.06.2021; 14.07.2021	Informacion ne lidhje me sa foshnja meshkuj dhe femra kane lindur ne RSH ne vitin 2015,2016,2017,2018,2019,2020; sa foshnja kane lindur pergjate viteve 2015,2016,2017,2018,2019,2020 specifikisht per secilin vit	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH, SUSN, SUOGJ1, SUOGJ2; Kthim Pergjigje te SUOGJ1 dhe SUOGJ2	E deleguar/ E plotë
112	15.06.2021	16.06.2021	Informacion ne lidhje me nr fabrikash dhe uzinash qe jane inspektuar ne RSH 2010-2021; sa nga keto paraqesin rrezik per shkak te mbetjeve kimike; cilat jane dhe lokalizimet e tyre; etj	Percjellje per kompetence dhe trajtim ISHSH	E deleguar
113	15.06.2021	17.06.2021	Informacion ne lidhje per marrje autorizimi per udhetim ne Greqi me qellim kurimi	Pergjigje per: 1. Kërkesë për pajisje me Autorizim për të udhëtuar jashtë vendit për arsye shëndetësore, e cila mund të bëhet edhe nëpërmjet e-mailit në adresën elektronike: alida.mici@shendetesia.gov.al , eriselda.levanaj@shendetesia.gov.al , klaudia.isufaj@shendetesia.gov.al ; 2. Fotokopje e pasaportës së pacientit, si dhe kopje të pasaportës së personave që do të shoqërojnë pacientin;3.Epikrizën e pacientit, të lëshuar nga klinika/spitali në vendin tone; Në rast se pacienti ndiqet jashtë vendit, Epikrizën të lëshuar nga klinika/spitali në Greqi, e përkthyer në gjuhën shqipe;4. Letrën nga Spitali në Greqi mbi trajtimin e pacientit, ku tregohet data në të cilën do të paraqitet pacienti në spital, e përkthyer në gjuhën shqipe(minimalisht 15 ditë pune nga dita që bëni kërkesën në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mënyrë që të keni kohën e duhur për ta ndjekur dhe në Ministrinë e Jashtme dhe të merrni konfirmimin nga pala Greke);5. Në rast se do të udhëtohet në rrugë tokësore, duhet të paraqiten të dhëna mbi tipin dhe targën e automjetit;6.Një numër telefoni ku mund t'ju kontaktojmë.	E plotë

114	15.06.2021	30.06.2021	<p>Informacion nese MSHMS ka nje protokoll per turistet dhe udhetaret e huaj qe vijne ne RSH;nese kane nevoje turistet apo udhetaret e huaj te pavaksinuar te kryejne testim PCR per covid 19 perpara dhe pas hyrjes ne RSH;nese ka MSHMS ndonje protokoll per ofrimin e testimit per covid 19 ne rast udhetimi jashte vendit;nese ka nje opsion per perfitimn e sherbimit pervec pageses tek subjekti jopublik;procedura qe nje qyetetar te perfitoje sherbim prej ISHP, mjekut te familjes pa pasur nevoje per kryerjen e analizave ne subjektet jopublike; nese MSHMS parashikon nje sherbim analog si privati per testim vullnetar/te kerkuar nga personi me apo pa kunderpagese;rastet ne te cilat autoritetet shteterore kryejne testimet per covid 19.</p>	<p>Pergjigje/informacion per miratimin e protokollit te masave anticovid 19 pergjate sezonit turistik me urdher nr.295, date 18.06.2021 “Per miratimin e protokollit te masave anticovid19 pergjate sezonit turistik”; nuk ka kufizime per hyrjen ne territorin e RSH ne lidhje me masat mbrotjese anticovid; MSHMS ka kryer vaksinim me te gjere se sa mund te parashtrohet; Bazuar ne Urdher nr. 437, date 23.07.2020 “Per Miratimin e procedures se kryerjes se testeve molekulare RT-PCR per Sars-cov2 dhe Njohjes se laboratoreve jopublike per kryerjen e testimit per nevoja administrative”, testimi PCR mund te kryhet ne struktura shendetesore jopublike per efekt adminsitrativ; testimi per covid 19 ne strukturat e sistemit shendetesor public mbeshtetet ne diagnose, pra ne rast se je l dyshuar per covid19.</p>	E plotë
115	16.06.2021	21.06.2021	<p>Informacion per protokollet qe zbatohen per kurimin e covid 19 ne spital dhe ne shtepi te miratuara nga MSHMS; nese zbatohet ne RSH nje protokoll per medikamentet anticovid ne stade te ndryshme te semundjes dhe cilat jane ato per cdo stad; informacion ne lidhje me partneritetin Italian “Regional Cooperation Council” i cili ka shperndare udhezime per trajtimin e pacienteve me covid 19 per vendet e Ballkanit perendimor apo zbatohet nga pala e RSH; ne protokollet e kurimit te covid 19 ne kushte spitalore nese eshte aplikuar kurimi i pacienteve me ilacet deksametazon dhe remidisivir/remivir.</p>	<p>Informacion : Protokollet e mjekimit per covid 19 per te infektuarit ne RSH dhe ata ne banese jane miratuar me Urdher Nr. 579, date 14.10.2020 “Per Miratimin e Udhezuesit mbi ndjekjen ne shtepi te rasteve me infeksion covid19”; Rekomandimi I OBSH-se qe spitalet do te merren me menaxhimin klinik te covid 19 te ndertonin prtokollet e tyre; të ndërtonin protokollet e tyre duke u bazuar në eksperiencën e dy epidemive të koronavirusave të mëparshme dhe rezultatet e arritura, deri tani, në lidhje me përgatesa të ndryshme, që hamëndësoshin si probabël efikase për trajtimin e sëmundjes.Madje në udhëzuesit e OBSH u përdor një term i veçantë: "off label". Ky term nënkuptonte se disa përgatesa mund të përdorshin, edhe si përpjekje terapeutike, nga spitale të ndryshme në të njëjtin vend, por edhe të shteteve të ndryshme (të afta për këtë objektiv) dhe rezultatet e tyre do të përmbledheshin dhe studioheshin e analizoheshin me qëllim, që të arriheshin disa përfundime të qarta në këtë drejtim.Spitali Covid-1, ka zbatuar tre protokolle, që janë përmirësimit dhe përshtatje me të mira të arritjeve dhe përvojave të reja. Që në fillim të pandemisë, Spitali Covid 1 ka ndërtuar Protokollin e Parë të Menaxhimit Klinik të Covid 19, duke përshtatur Udhëzuesit e OBSH-së dhe të disa Shoqatave Infektologjike dhe Spitaleve më të përparuara të botës, në mënyrë, që të përballonin sa më mirë këtë sulm pandemik mbi popullsinë e vendit tonë (14 shkurt 2020).Njohja më e mirë e sëmundjes dhe arritjet shkencore klinike ndaj saj, nga ekiye mjekësore në vende të ndryshme, u evidentua edhe nga ne, me ndërtimin e Protokollit të Dytë të Menaxhimit të Covid -19 (21 maj 2020). Protokollit i Tretë (21 janar 2021) është një rishikim i të mësipërmit, që reflekton kryesisht arritjet në drejtim të Koagulopatisë dhe Sindromit Trombofilik të lidhur me Covid-19.; Terapinë me Serumin Hiperimun nga konvaleshentët dhe ARDS (zgjerimin e aplikimit të Dexametazonit e tjerë). Protokollet në fjalë janë ndërtuar mbi bazën e: - rekomandimeve të OBSH-së,-përvojës dhe protokolleve të ekiyeve mjekësore të shteteve të ndryshëm të botës (që botohen dhe përditësohen herë pas here);-konsultave “ on line ” me drejtues, anëtarë të klinikave dhe spitaleve të disa shteteve, që luftojnë me sëmundjen, me të cilët kemi kontaktuar herë pas here (Ospedale San Gerardo Monza,Itali, Evanson Hospital, Illinois,USA; Saint Anthony Hospital, Chicago,USA; Middlesey Health Middlestoïn, New York, USA; Brigham and Women’s Hospital,Massachusetts, Boston, USA); - bashkëbisedimeve direkte me ekiye të ardhura në Shqipëri në kuadrin e shkëmbimeve të praktikës dhe ndihmës për Covid-19 si të OBSH-së (21 gusht 2020 dhe 3 nëntor 2020); ekspertë të Covid-19 të</p>	E plotë

				<p>Istituto Superiore di Sanita,Rome,Itali (18-24 gusht 2020); anëtarë të Komitetit të Ekspertëve të Covid-19 të Republikës së Turqisë (16 dhjetor 2020). -përvojës shumëvjeçare të Shërbimit Infektiv;- përvojës shumëvjeçare të Shërbimit të Reanimacionit,që bashkëpunon dhe menaxhon, çdo ditë, drejtpërsëdrejti “në terren” të sëmurët me COVID -19 (për aspektet intensiviste/reanimatore);- konsultave të vazhdueshme me Shërbimin e Pneumologjisë dhe specialiteteve të ndryshëm, që kontribuojnë në trajtimin e pacientëve tanë.Deri tani nuk ka ende antivirale, apo përgatesa antisars cov2 të sigurtë dhe të certifikuar. Mjekimi i ndërlikimeve të tjera dhe përkeqësimit të disfunksioneve ekzistuese të organeve të ndryshme bazohet në protokollet e veçanta të tyre sipas rastit dhe rëndesës përkatëse. Në spitalin Covid 2, në përputhje me rekomandimet e WHO (OBSH) , protokollit i trajtimit ka qenë zbatimi i ndërthurjes se 6 guidelines si: -protokollit i pneumonisë komunitetit; -trombembolisë pulmonare; - insuficiencës respiratore; - detresit resirator ; - ventimit jo invaziv dhe invaziv dhe i oksigjenoterapisë. Informacion se nuk dihet se ka diferenca mjekuese dhe udhëzime të veçanta per trajtimin e Covid -19 sipas zonave të caktuara gjeografike. Edhe vetë OBSH nuk ka rekomanduar apo paraqitur protokolle terapeutike të kësaj sëmundje të cilat të jenë në vartësi të rajoneve gjeografike në botë. Megjithë sa më sipër, sqarohet se deri tani nuk ka asnjë medikament të mirefilltë anticovid . Aplikimi i tyre (2 medikamentet ne covid1, dhe Dexametazoni ne covid 2) është bërë duke patur parasysht sindromat patologjike të koronavirusës, rëndesën e pacientit, stadin e ecurisë së sëmundjes si dhe indikacionet dhe kundëriindikacionet specifike.</p>	
116	16.06.2021	25.06.2021	Informacion se në çfarë faze është rindërtimi i spitalit të Laçit; kur pritet perfundimi, arsyet e vonesave.	<p>Pergjigje/Informacion se rindërtimi i Spitalit të Lacist, bazuar në projekt-preventivin e zbatimit të miratuar është në fazën e kryerjes së volumeve kryesore të punimeve të ndërtimit dhe atyre të montimit të strukturës metalike,që janë duke u monitoruar në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat përkatëse.Punimet për përfundimin e ndërtimit zhvillohen në mënyrë të pandërprerë dhe parashikohen të përfundojnë brenda muajt shtator 2021.Të gjitha shërbimet spitalore, që ofroheshin nga Spitali i Laçit nuk janë ndërprerë për asnjë moment dhe vijojnë të ofrohen konform të gjitha kushteve në ambientet alternative të siguruar nga Drejtoria e Spitalit Bashkiak të Laçit. Vonesat gjatë ekzekutimit të punimeve kanë ardhur si pasojë e faktorëve dhe kushteve teknike të paparashikuara, rregullimi i të cilave është i përcaktuar edhe në legjislacionin në fuqi por edhe në kushtet e kontratës.</p>	E plotë
117	17.06.2021	22.06.2021	Informacion per rekomandime kryerje vizite gjinekologjike	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH	E deleguar
118	17.06.2021	22.06.2021	Informacion ne lidhje me marreveshjen e lidhur me kompanine Phizer Overseas LLC dhe MSHMS, ISHP, MSHR miratuar me akt normativ date 16.06.2021, te dhena per kompanine pale si nr. identifikimi, seli apo rregjister tregtar.	Informacion qe me Aktin Normativ Nr. 24, date 16.06.2021 eshte miratuar teksti I marreveshjes per prodhimin dhe furnizimin nga dhe nepermjet “Pfizer Overseas LLC” dhe MSHMS, ISHP, MSHR. Fletore Zyrtare Nr. 95, date 17.06.2021 mund te gjenerohet informacioni qe eshte i aksesueshem per publikun.	E plotë

119	18.06.2021	30.06.2021	Informacion per vaksinim dhe personat qe duan te studiojne jashte vendit dhe duan te vaksiohen	Informacion qe mund te komunikohet me mjekun e familjes se qendres shendetesore edhe pse levizja ne nivel iternacional pas lehtesimit te masave nuk kerkon vaksinim te detyrueshem	E plotë
120	19.06.2021	30.06.2021	Informacion per kryerje tampon PCR ne spital per shteteasit e huaj-grupe turistesh	Kryerja e testit PCR per efekt administrativ kryhet nga strukturat shendetesore jopublike	E plotë
121	21.06.2021	30.06.2021	Informacion ne lidhje me fonde totale te dhena per sektorin e shendetesise per periudhe referente ; fonde te dhena per perballimin e pandemise per periudhe referente; shperndarja e tyre sipas produkteve, sipas llojit te sherbimit per periudhe referente; nr I te infektuarve total ne qarqe dhe grupmosha, sa trajtim ne spital; informacion sa nga fondet covid perdoren per sherbim spitalor dhe shpenzime te tjera; parashikimi kontigjenca per vitin 2022 per perballimin e nje rikthimi te mundshem te pandemise.	Percjelle per kompetence dhe trajtim OSHKSH, ISHP, QSUT, SUSN	E deleguar
122	21.06.2021	07.07.2021	Informacion nese lejohen te futen ne Shqiperi produkte kozmetike me perberje vaj kanabisi.	Pergjigje bazuar ne Ligjin Nr.7975, datë 26.7. 1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar, tabelat e lëndëve bashkëlidhur së cilit, janë përpiluar sipas Konventës Unike për Barnat Narkotikë të vitit 1961 dhe Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971;VKM Nr. 395, datë 27.06.2018 “Për miratimin e listës së substancave të ndaluara ose me përdorim të kufizuar për produktet kozmetike”, Shtojca I “Lista e lëndëve të ndaluara për produktet kozmetike”; Ligjin Nr. 8723, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, e ndryshuar nga protokollin e vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961”;CosIng – Bazën e të dhënave për informacion mbi produktet kozmetike dhe përbërësit e tyre, ndalohet që një produkt kozmetik të përmbajë droga natyrale dhe sintetike, përfshirë këtu të gjitha substancat e listuara në tabelën I dhe II të Konventës së Vetme për Drogat Narkotike të firmosur në Nju-Jork, më 30 mars 1961. Duke vijuar më tej, referuar dispozitave përkatëse të ligjeve cituar në pikat 1 dhe 3 më sipër, termi Cannabis nënkupton majat e lulëzuara dhe të frutifikuara të bimëve të gjinisë cannabis, duke përjashtuar farërat dhe gjethet kur këto nuk janë të shoqëruara me majat, prej të cilave nuk është hequr rrëshira, pavarësisht nga emri që ato mund të kenë. Referuar klasifikimit të pasqyruar në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar, Cannabis, rrëshira, ekstrakti dhe tinktura e tij, përfshihen në Tabelën I, Lista IV (Konventa e 1961). Lidhur me vajin nga farat e Cannabis-it (Cannabis Sativa Seed Oil), CAS Nr. 89958-21-4, konfirmojmë se bazuar në termin përkufizues të Cannabis-it, sipas akteve ndërkombëtare dhe atyre kombëtarë në fuqi për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope (cituar më lart), farat e kanabisit përjashtohen nga përkufizimi i këtij termi, vetëm nëse nuk janë të shoqëruara me majat, prej të cilave nuk është hequr rrëshira. Bazuar në informacionin e marrë nga baza e të dhënave CosIng, nuk paraqiten kufizime në lidhje me këtë produkt (Cannabis Sativa Seed Oil). Sqarim se do të ishte me e pershtatshme dhenia e nje informacioni teknik më të detajuar mbi përqëndrimin e lëndëve përbërëse në vajin e farave të Cannabis-it, si p.sh. Δ9-THC (Tetrahydrocannabinol), për të cilin, për shkak të	E plotë

				efekteve psikoaktive, parashikohen kufizimet përkatëse në legjislacion.	
123	23.06.2021	22.07.2021	Informacion ne lidhje me aktivitetet qe lejohet te ushtrojne veprimtarine e tyre me ose pa kufizime	Informacion per zbatimin e Urdhrit Nr.351, date 29.05.2020 "Per marrjen e masave te vecanta dhe kufizimeve per parandalimin e perhapjes se Covid19", te ndryshuar botuar ne FZ Nr.99, date 01.06.2020	E plotë
124	25.06.2021	12.07.2021	Informacion lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës së mjekëve me institucionet shëndetësore publike, kur mjekët janë duke ndjekur studimet afatgjata në fushën e mjekësisë pranë universiteteve private. Informacion si rregullohet marrëdhënia e punës në rastet kur mjekët që janë të punësuar në institucionet shëndetësore publike dhe janë duke ndjekur ndërkohë studimet afatgjata në fushën e mjekësisë; cilat janë udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rastet kur studimet afatgjata që po ndiqen nuk janë të mbuluara nga kuota të ministrive dhe as nuk janë duke u ndjekur në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, por janë duke u ndjekur në institucion privat? Duhet të ndërpritet marrëdhënia e punës së mjekut? A mund ta vijojë këtë marrëdhënie pune, ndërkohë që vijon edhe studimet afatgjata në universitet privat?	Pergjigje/Informacion qe marrëdhënia e punës e personelit shëndetësor pranë institucioneve shëndetësore publike rregullohet nga dispozitat e Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe kohëzgjatjen ditore dhe javore normale të punës (8 orë në ditë / 40 orë në javë).Bazuar në kontratën individuale të punës dhe Ligjin Nr. 7961/1995 angazhimi i mjekëve pranë institucioneve shëndetësore publike bëhet me kohë të plotë pra 8 orë në ditë/ 40 orë në javë. Në çdo rast Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon zbatimin e kontratës individuale të punës për personelin mjekësor me qëllim final ofrimin e plotë të shërbimit shëndetësor ndaj qytetarëve në çdo insitucion shëndetësor publik.	E plotë
125	29.06.2021	16.07.2021	Informacion sa dhe cilët laboratore janë akredituar nga Ministria e Shëndetësisë për kryerjen e analizave të formës PCR për COVID-19; Sa prej laboretove/klinikave janë akredituar nga MSHMS për kryerjen e testimit të formës PCR për COVID-19, dhe a është i nevojshëm një akreditim nga MSHMS për marrjen e tamponeve të personave të ndryshëm ne qytete referente: Shkoder, Durres, Tirane; Informacion nese MSHMS ka vendosur nje cmim reference për tamponët PCR, si kosto për qytetarin; Informacion sa eshte kosto për MSHMS për kryerjen e një testimi dhe analiza PCR për COVID-19.	Informacion ne baze te Urdhrit Nr. 437, date 23.07.2020 "Per Miratimin e Procedures se Kryerjes se Testimit per nevoja administrative", MSHMS ka njohur labororet joublike te referuar. Informacion per percaktimin e cmimeve prej tyre strukturave si struktura private per listen e sherbimeve; Informacion per subjektet jopublike qe kane dakordesuar per reduktimin e cmimit ne 6,500 leke, kryerja e testimit ne PCR per sars cov2 ne ISHP dhe te gjithë strukturat shendetesore publike, vijon te jete falas	E plotë
126	29.06.2021	30.06.2021	Informacion per aplikim vaksine specifike	Pergjigje per paraqitjen prane pikave te vaksinimit masiv ne dy ditet e hapura per vaksinim duke aplikaur paraprakisht tek portal e-albania.	E plotë
127	29.06.2021	02.07.2021	Informacion per nr qyetaresh qe kane injektuar vaksine specifike.	Percjellje per kompetence dhe trajtim OSHKSH; ISHP	E deleguar

128	30.06.2021	30.06.2021	Informacion si paraqitet lista e vdekjeve dhe semundshmerise ne periudhe referente dhe vende te caktuara, semundjet me te zakonshme sipas grupmohave	Percjelle per kompetence dhe trajtim OSHKSH	E deleguar
